



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË VLORË

KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE

Me shkresen nr. 2435/1 prot B.SH datë 25.07.2019 Minisitria e Drejtësisë ka transmetuar kërkesën e autoriteteve greke të drejtësisë dhe dokumentacionin përkatës për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit penal të dhënë ndaj shtetasit shqiptar Bardhosh Lytaj alias Mino , i biri i Spiro dhe Marie , lindur më 21.06.1972, lindur dhe banues në Vlorë , Shqipëri.

Shtetasi shqiptar Bardhosh Lytaj alias Mino mbi bazën e vendimit nr.852 datë 14.12.2015 nga Gjykata e Apelit njëanëtarëshe të Krimeve të Rënda të Patras , Greqi , konfirmuar me vendim të formës së prerë më datë 09.09.2016 , për kryerjen e veprave penale, *“Vrasjes me dashje” e kryer në bashkëpunim, “Grabitja e kryer” në bashkëpunim, “Armëmbajtjes pa leje”, “Përdorimi i paligjshëm i armës”, “Zotërimi dhe transportimi i një sasive të madhe lendë narkotike”, “Falsifikimit”, dhe “Vjedhjes se energjisë elektrike”,* parashikuar nga legjislacioni penal grek.

Lidhur, sa më sipër , në mbështetje të Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë *“Për ekzekutimin e ndërsjelltë të vendimeve gjyqësore për cështjet penale ”* datë 17.05.1993, nenit 512/3 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 53/5 të ligjit nr.10193 datë 03.12.2009 *“Për marrëdhëniet juridksionale me autoritetet e huaja në cështjet penale ”*, ju përcjellim një kopjo të dokumentacionit përkatës dhe njëkohësisht kërkojnë nga ana e shtetit shqiptar kryerjen e veprimeve përkatëse procedurale për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit penal grek ndaj shtetasit shqiptar Bardhosh Lytaj alias Mino në Shqipëri.

Po kështu nga te dhenat e mesiperme eshte domosdoshme e marrja e masave shtrenguese me qëllim njohjen e vendimit penal grek të shtetasit Bardhosh Lytaj alias Mino në Shqipëri.

Gjithashtu referuar materialeve te publikuara nga autoritetet greke, rezulton se eksiztojnë te dhena te hollësishme për veprat penale që ka konsumuar ky shtetas, si dhe per identifikimin e tij. Bazuar në nenin 494 K.Pr.Penale , permbushen kërkesat ligjore që ndaj shtetasit shqiptar Bardhosh Lytaj alias Mino te caktohet kerkesa arrest ne burg pa afat me qëllim njohjen dhe ekzekutimin e këtij vendimi penal .

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë kerkon caktimin e masës se sigurimit personal *“arrest ne burg ”* me qëllim njohjen dhe ekzekutimin e këtij vendimi penal dhe se ne zbatim te ketyre kerkesave jemi ne pritje te dokumentacionit perkates. Ne momentin kur keto akte te vihen ne dispozicion organi i akuzës i qëndron idesë se masa e sigurimit personal *“arrest ne burg*

” është masa më përshtatshme si masë shtrënguese për nevojat e njohjes dhe ekzekutimit të vendimit penal grek në Shqipëri.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr.196 dt. 06.08.2019 ka vendosur caktimin e masës shtrënguese “arrest ne burg” në zbatim të nenit 494 K.Pr.Penale me qëllim njohjen e vendimit penal të huaj. Në këto kushte Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka lëshuar urdhër ekzekutimi me qëllim vënien në ekzekutim të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, nga shërbimet e policisë gjyqësore pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë.

Neni 490

Kushtet e ekstradimit

1. Ekstradimi lejohet me kusht të shprehur se i ekstraduari nuk do të ndiqet, nuk do të dënohet dhe as do t'i dorëzohet një shteti tjetër për një veprë penale që ka ndodhur para kërkesës për dorëzim dhe që është e ndryshme nga ajo për të cilën është dhënë ekstradimi.
2. Kushtet e treguara nga paragrafi 1 nuk merren parasysh:
 - a) kur pala dorëzuese jep pëlqim të shprehur që i ekstraduari të ndiqet edhe për një veprë penale tjetër dhe i ekstraduari nuk ka kundërshtim;
 - b) kur i ekstraduari, edhe pse ka patur mundësi, nuk ka lënë territorin e shtetit të cilit i është dorëzuar, pasi kanë kaluar dyzet e pesë ditë nga lirimi i tij ose pasi e ka lënë atë është kthyer vullnetarisht.
3. Ministria e Drejtësisë mund të vërë edhe kushte të tjera që i çmon të përshtatshme pa tejkalluar parashikimet e akteve ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë dhe rezervat e deklaratimet ligjore.

Neni 491

Mospranimi i kërkesës për ekstradim

Nuk mund të jepet ekstradimi:

- a) për një veprë me karakter politik ose kur rezulton që ai kërkohet për qëllime politike;
- b) kur ka arsye të mendohet se personi që kërkohet do t'u nënshtrohet persekutimeve ose diskriminimeve për shkak të races, fese, seksit, shtetësisë, gjuhës, bindjeve politike, gjendjes personale a shoqërore ose denimeve a trajtimeve të egra, c'njerezore a poshteruese ose veprimeve që përbejnë shkelje të një të drejte themelore të njeriut;
- c) kur personi që kërkohet ka kryer një veprë penale në Shqipëri;
- c') kur ka filluar procedimi ose është gjykuar në Shqipëri edhe pse vepra është kryer jashtë shtetit;
- d) kur vepra penale nuk parashikohet si e tillë nga legjislacioni shqiptar;
- dh) kur për veprën penale është dhënë amnisti nga shteti shqiptar;
- e) kur personi i kërkuar është shtetas shqiptar dhe nuk ka marrëveshje që të parashikojë ndryshe;
- e) kur është parashkruar ndjekja penale ose dënimi sipas ligjit të shtetit të kërkuar;

f) kur personi i kërkuar është dënuar në mungesë, me përjashtim të rastit kur shteti kërkuar jep garanci për rishikimin e vendimit.

Neni 514 K.Pr.Penale

Kushtet e njohjes

1. Vendimi i gjykatës së huaj nuk mund të njihet kur:
- a) vendimi nuk ka marrë formë të prerë sipas ligjeve të shtetit ku është dhënë;
 - b) vendimi përmban disponime në kundërshtim me parimet e rendit juridik të shtetit shqiptar;
 - c) vendimi nuk është dhënë nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme ose i pandehuri nuk është thirrur të paraqitet në gjykim ose nuk i është njohur e drejta që të pyetet në një gjuhë që e kupton dhe të ndihmohet nga një mbrojtës;
 - ç) ka arsye të bazuara për të menduar se kanë ndikuar në përfundimin e procesit konsiderata lidhur me racën, fenë, seksin, gjuhën apo bindjet politike;
 - d) fakti për të cilin është dhënë vendimi nuk parashikohet si vepër penale nga ligji shqiptar;
 - dh) për të njëjtin fakt dhe ndaj të njëjtit person, në shtetin shqiptar është dhënë një vendim i formë së prerë ose zhvillohet një procedim penal.

Neni 67

Mosparashkrimi i ndjekjes penale

Nuk i nënshtrohen parashkrimit të ndjekjes penale krimet e luftës dhe ato kundër njerëzimit.

Neni 68

Parashkrimi i ekzekutimit të dënimit

Vendimi i dënimit nuk ekzekutohet kur nga dita që ka marrë formë të prerë kanë kaluar:

- a) njëzet vjet për vendimin që përmban dënim pesëmbëdhjetë gjer në njëzetepesë vjet burgim;
- b) dhjetë vjet për vendimin që përmban dënim pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet burgim;
- c) pesë vjet për vendime që përmbajnë dënim me burgim gjer në pesë vjet ose dënime të tjera më të lehta.

Në vijim të kesaj kërkesë për ekstradim në origjinal i janë bashkëngjitur; 1. Kopja e vendimit të dënimit me burgim ose e aktit të procedimit; 2. Nje relacion mbi veprën penale që i ngarkohet personit për të cilin kërkohet procedimi; 3. Teksti i dispozitave ligjore që është shkelur; 4. Te dhenat individuale mbi identitetin e personit që kërkohet ekstradimi.

Faktet juridike të mësipërme provohen me;



- Shkresa me nr.89/7 /K.A prot dt.30.07.2019 të Prokurorisë së Përgjithshme, nga Drejtoria e Marëdhënieve Juridiksionale me Jashtë,
- Shkresën nr. 2435/1 Prot B.SH datë 30.07.2019 të Minsitrisë së Drejtësisë;
- Përmbledhje e fakteve penale;
- Tekstin e dispozitave ligjore;
- Vendimi nr.852 datë 14.12.2015 nga Gjykata e Apelit njëanëtarëshe të Krimeve të Rënda të Patras , Greqi , konfirmuar me vendim të formës së prerë më datë 09.09.2016;
- Praktika e lokalizimit të subjektit;
- Urdher ekzekutimi i vendimit nr. 196 dt. 06.08.2019 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë;
- Leternjoftime te ketij shtetasi; .

Per efekt te njehsimit te praktikës gjyqësore, Kolegjet e Bashkuara pranojnë se per te gjykuarin Bardhosh Lytaj alias Mino dhe ne cdo rast, vendimi i Gjykates Shqiptare nuk eshte nje vendim i ri. Per kete shkak, gjykata shqiptare nuk shqyrton çeshtjen ne themel dhe as nuk verifikon provat e marra nga gjykata e huaj. Ajo verifikon nese ekzistojne kushtet per njohjen e vendimit te huaj dhe duhet t'i pergjigjet atij vendimi me nje vendim qe konverton denimin e huaj me nje denim te parashikuar nga legjislacioni Shqiptar, duke peraktuar edhe dispozitat perkatese te cilat aplikohen. E rendesishme sipas Kolegjeve te Bashkuara eshte te evidentohet fakti se eshte vendimi i huaj ai qe vihet ne ekzekutim nepermjet nje vendimi njohes te gjykates Shqiptare. Pra nuk kemi te bejme me nje vendim te gjykates shqiptare qe vihet ne ekzekutim, por me nje vendim te nje gjykate te huaj qe ekzekutohet ne perputhje me legjislacionin shqiptar. Kolegjet e Bashkuara pranojnë faktin se transferimi i personave te denuar nga nje shtet i huaj, eshte nje zgjerim i juridiksionit te autoritetit gjyqësor te huaj ne Shqiperi, i cili perfundon mbas njohjes dhe ekzekutimit te tij ne Shqiperi.¹

Kur ben njohjen e nje vendimi penal te huaj, sipas ligjit tone penal, gjykata cakton denimin qe duhet te vuhet ne shtetin shqiptar. Gjykata konverton denimin e caktuar ne vendimin e huaj ne nje nga denimet e parashikuara per te njejtin fakt nga ligji shqiptar, i cili duhet t'i pergjigjet nga natyra atij qe eshte dhene ne vendimin e huaj. Masa e denimit nuk mund te kaloje kufirin maksimal te parashikuar per te njejtin fakt nga ligji shqiptar. Ligji parashikon edhe rastin kur ne vendimin e huaj nuk eshte caktuar masa e denimit dhe mban qendrimin se eshte gjykata shqiptare ajo qe cakton ate mbi bazen e kriterëve te treguara ne Kodin Penal. Pervец ketyre, ne nenin 516 te Kodit te Procedures Penale trajtohen edhe rregullat e caktimit te denimit lidhur me vendime penale te shteteve te huaja qe kane te bejne me caktimin e denimeve me gjobe

¹ Vendimi Unifikues Gjyqësor se Larte nr.154/2000

konfiskimeve, kur i pandehuri është liruar me kusht ose kur ekzekutimi i vendimit të dhënë në shtetin e huaj është pezulluar me kusht.

Në rastin e konvertimit të dënimit sipas Konventës, gjykata e shtetit zbatues nuk mund të konvertojë një dënim me burgim në një dënim me gjobe, gjykata mund të shkurtojë periudhën e plote të heqjes së lirise që vuhet nga personi i denuar. Gjykata nuk e rendon dënimin e personit të denuar dhe nuk është e detyruar t'i përmbahet ndonjë minimumi që mund të parashikojë ligji i vendit zbatues për veprën ose veprat e kryera.²

Kurse njohja e vendimeve penale të formës së prere të gjykatave të huaja për kategorinë e dyte, d.m.th., për të denuarit, shtetas shqiptarë, për të cilët vendimi penal i formës së prere nuk ka filluar të vihet në ekzekutim dhe që janë me banim në shtetin shqiptar, si rregull, bëhet kur kërkohet për të denuar të cilet, ose janë denuar në mungesë nga gjykata e huaj, ose duke qenë në gjendje të lire, pas dënimit, kanë lënë vendin e huaj dhe kanë ardhur në Shqipëri. Në këtë kategori, duhet të përfshihen edhe të denuarit, shtetas shqiptarë, të cilet, megjithatë vendimi penal ndaj tyre, ka filluar të vihet në ekzekutim në shtetin e huaj, vuajtja e metejshme e dënimit, atje, është ndërprere, pavaresisht nga shkak (arratisja e të denuarit nga burgu, moskthimi i tij nga leja, etj).³

Për këto arsye në bazë të neneve 512, 513, 514, 515, 516, 518 të K. Pr. Penale, nenit 67, 68 K. Penal, Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë "Për ekzekutimin e ndërsjellë të vendimeve gjyqësore për çështjet penale" datë 17.05.1993 dhe të Konventës Europiane për Ndihmë Juridike dhe Çështjeve Penale të 20 Prillit të vitit 1959, ratifikuar me Ligjin Nr 9871 datë 11.02.2008, hyrë në fuqi me datë 01.08.2011;

Përfundimisht kërkohet prej gjykatës që :

- Njohjen e vendimit penal të grek të dhënë nga Gjykata e Apelit njëanëtarëshe të Krimeve të Rënda të Patras, Gjykata e Apelit njëanëtarëshe të Krimeve të Rënda të Kritit dhe Gjykata Penale e Shkallës së Parë Kyrkyra, Greqi, nga ndaj shtetasit shqiptar Bardhosh Lytaj alias Mino, i biri i Spiro dhe Marie, lindur më 21.06.1972, lindur dhe banues në Vlorë, Shqipëri.
- Konvertimin e dënimit penal të caktuar në vendimet penale të shtetit grek, ku parashikohet vuajtja e dënimit penal për veprën penale të "Vrasja me dashje e kryer në bashkëpunim" të parashikuar nga neni 76-25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 18 vjet burgim.
- Konvertimin e dënimit penal të caktuar në vendimet penale të shtetit grek, ku parashikohet vuajtja e dënimit penal për veprën penale të "Vjedhja me pasojë vdekjen" të parashikuar nga neni 141 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me burgim të përjetshëm.

² Vendimi Unifikues Gjykatës së Lartë nr. 5/2002

³ Vendimi Unifikues Gjykatës së Lartë nr. 1/2003

- Konvertimin e dënimit penal të caktuar në vendimet penale të shtetit grek , ku parashikohet vuajtja e dënimit penal për veprën penale të “*Prodhimi dhe mbajtja pa leje armeve të ftohta*” të parashikuar nga neni 279/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 vit burgim.
- Konvertimin e dënimit penal të caktuar në vendimet penale të shtetit grek , ku parashikohet vuajtja e dënimit penal për veprën penale të “*Prodhimi dhe shitja e narkotikeve*” të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 6 vjet burgim.
- Konvertimin e dënimit penal të caktuar në vendimet penale të shtetit grek , ku parashikohet vuajtja e dënimit penal për veprën penale të “*Falsifikimi i dokumentave*” të parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 5 muaj burgim.
- Konvertimin e dënimit penal të caktuar në vendimet penale të shtetit grek , ku parashikohet vuajtja e dënimit penal për veprën penale të “*Vjedhja e energjisë elektrike*” të parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 5 muaj burgim.
- Ne aplikim të nenit 55 të Kodit Penal të caktohet një dënim i vetëm , i llojit më të rëndë me burgim të përjetshëm.
- Vuajtja e dënimit të kryhet në një burg te sigurisë së lartë, duke urdhëruar policinë gjyqësore per ekzekutimin e këtij vendimi penal.
- Shpenzimet procedurale të paguhen nga i pandehuri.

PROKUROR

Saimir SMAKA

